

MASTER

PROFESIONAL **60 ECTS** NË

MARKETING DIGJITAL & KOMUNIKIM

NEW

BËHU PROFESIONIST

I MARKETINGUT

TË SË ARDHMES!

Kohëzgjatja: **2 semestre**

Gjuha: **Shqip - Anglisht**

Fakulteti i: **Biznesit dhe Drejtësisë**

Skano
për më
shumë
info





Të nderuar studentë,
Mirë se vini në Masterin Profesional në Marketing Digjital dhe Komunikim!
Kam kënaqësinë t'ju uroj mirëseardhjen në këtë program të veçantë, i cili përfaqëson një mundësi emocionuese dhe të pasur për zhvillimin tuaj në fushën e marketingut digjital dhe komunikimit. Si Zëvendës Dekane e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë, jam e sigurt se do të përfitoni shumë nga ky udhëtim akademik. Kurrikula është e avancuar dhe e strukturuar, duke pasqyruar trendet dhe teknologjitë më të fundit të industrisë, dhe ju ofron mundësinë për të mësuar e aplikuar njohuri dhe aftësi thelbësore për një karrierë të suksesshme në këtë fushë.

Në një botë që po bëhet gjithnjë e më e digjitalizuar, programi ynë është krijuar për t'ju ofruar një bazë të fortë që do t'ju ndihmojë të zhvilloni strategji inovative dhe të menaxhoni fushata që ndikojnë në ndërtimin e markave në një treg global. Ai fokusohet në zhvillimin e aftësive që janë thelbësore për udhëheqësit e marketingut të së ardhmes — nga analiza e avancuar e të dhënave dhe përdorimi i teknologjive më moderne, deri te krijimi i fushatave digjitale me ndikim real.

Përmes kësaj kurrikule, do të fitoni jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike që mund t'i aplikoni menjëherë në industrinë e marketingut dhe komunikimit. Ne besojmë se kjo përvojë akademike do të jetë një mundësi e çmuar për të mësuar, bashkëpunuar dhe për t'u rritur profesionalisht.

Po ashtu, do të keni mbështetje të plotë nga pedagogët tanë të përkushtuar, të cilët janë ekspertë në fushën e marketingut digjital dhe komunikimit. Ata janë të gatshëm t'ju udhëzojnë dhe të ndajnë përvojën e tyre për të siguruar suksesin tuaj gjatë gjithë këtij rrugëtimi akademik.

Ju urojmë një vit akademik të suksesshëm, ku do të përfitoni nga mundësitë e shumta për zhvillim dhe rritje!

Prof. Assoc. Aurela Braholli

Zv/Dekane e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë.

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Masteri Profesional në Marketing Digjital dhe Komunikim është konceptuar për të ofruar një përgatitje të thelluar dhe bashkëkohore në fushën e marketingut dhe komunikimit digjital. Programi është ndërtuar për të zhvilluar kompetencat që kërkon tregu i sotëm — nga përdorimi strategjik i mjeteve digjitale dhe analizës së të dhënave, deri te menaxhimi efektiv i komunikimit me audiencën dhe ndërtimi i markave konkurruese në mjedisin global.



Gjatë këtij programi, studentët do të mësojnë si të krijojnë dhe menaxhojnë përmbajtje strategjike për platformat digjitale, të përdorin teknika të avancuara të optimizimit të motorëve të kërkimit (SEO&SEM), si dhe të ndërtojnë strategji të suksesshme të kujdesit ndaj markës (branding) dhe komunikimit me audiencën. Programi gjithashtu përfshin lëndë të tilla si marketingu me profesionalizëm dhe kreativitet i përmbajtjes dhe etika, marketingu digjital dhe marketingu në media sociale, menaxhimi i markës, si dhe tregtia elektronike (e-commerce) dhe shitjet digjitale.

Studentët gjithashtu do të thellojnë njohuritë e tyre në automatizimin e marketingut dhe përdorimin e inteligjencës artificiale për përmirësimin e fushatave, si dhe do të zhvillojnë aftësi në planifikimin dhe blerjet përmes medias digjitale.

Ky program gjithashtu ofron mundësi konkrete për bashkëpunim dhe rrjetëzim me profesionistë të industrisë, duke siguruar zhvillim profesional.

AVANTAZHET KRYESORE NË PROGRAMIN MASTER PROFESIONAL NË “MARKETING DIGJITAL & KOMUNIKIM” (60 ECTS):

• INTEGRIMI I MARKETINGUT DHE KOMUNIKIMIT:

Qasje e avancuar që bashkon marketingun digjital me komunikimin strategjik, për të ndërtuar marka të forta dhe mesazhe me ndikim.

• QASJE NDËRDISIPLINARE DHE PRAKTIKE:

Theks i veçantë në aplikimin praktik të njohurive përmes projekteve reale, që zhvillojnë aftësitë për menaxhimin e fushatave dhe krijimin e strategjive digjitale.

• MENTORIM DHE “CHALLENGE-BASED LEARNING”:

Studentët punojnë në projekte reale të industrisë nën udhëheqjen e ekspertëve dhe mentorëve nga fusha e marketingut digjital dhe komunikimit.

• PARTNERITETE ME AGJENCI DHE KOMPANI LIDERE:

Programi ofron bashkëpunime konkrete me kompani të mirënjohura të sektorit, duke mundësuar eksperiencë praktike dhe mësim nga profesionistë aktivë të industrisë.

• MUNDËSI TË DREJTPËRDREJTA KARRIERE ME BALFIN DHE PARTNERËT:

Studentët përfitojnë nga praktikat profesionale dhe mundësitë e punësimit në mbi 200 kompani të Grupit BALFIN dhe rrjetit të partnerëve të TBU-së.

• KOMUNIKIMI MULTIKANAL:

Zhvillim i strategjive të integruara dhe multikanal për komunikim të harmonizuar në platforma të ndryshme.

• ZHVILLIMI I AFTËSIVE STRATEGJIKE DHE KREATIVE:

Përmirësim i mendimit kritik, aftësive analitike dhe krijuese për drejtimin e fushatave digjitale me ndikim.

• PËRGATITJE PËR CERTIFIKIME NDËRKOMBËTARE:

Programi ndihmon studentët të përgatiten për certifikime të njohura ndërkombëtarisht në fushën e marketingut digjital.

• RRJETËZIM ME PROFESIONISTË TË INDUSTRISË:

Mundësi për të ndërtuar kontakte profesionale dhe për të zgjeruar rrjetin në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

PERSPEKTIVAT E PUNËSIMIT

Ky program u ofron studentëve një gamë të gjerë mundësish punësimi në kompani të mëdha, start-up inovative dhe agjenci marketingu, si edhe aftësitë e nevojshme për të ndërtuar një biznes personal në fushën e marketingut digjital. Përmes kombinimit të njohurive teorike dhe praktikës profesionale, të diplomuarit janë të përgatitur të zhvillojnë karrierë të suksesshme në rolet kryesore të industrisë, si:

- 
1. Menaxher i Marketingu Digjital
 2. Menaxher i Mediave Sociale
 3. Specialist i SEO & SEM
 4. Menaxher i Përmbajtjes (Content Manager)
 5. Analist i të dhënave digjitale
 6. Manager i Komunikimeve dhe PR
 7. Krijues i Përmbajtjes dhe Copywriter
 8. Menaxher i Brandit
 9. Menaxher i Fushatave Digjitale
 10. Ekspert i Automatizimit të Marketingut
 11. Specialist i Tregtisë Elektronike
 12. Këshilltar i Rrjeteve Sociale dhe Komunikimit

SEKTORËT DHE KOMPANITË KU MUND TË PUNËSOHEN STUDENTËT:

- Sektori i Marketingut dhe Reklamës
- Sektori i Teknologjisë dhe Startupeve Digjitale
- Sektori i Tregtisë Elektronike (E-commerce)
- Sektori i Medias dhe Botimeve
- Sektori i Shërbimeve Financiare dhe Bankave
- Sektori i Komunikimeve dhe Marrëdhënieve me Publikun
- Sektori i Turizmit dhe Hotelerisë
- Sektori i Shëndetësisë dhe Farmaceutikës
- Sektori i Arsimit
- Sektori i Automobilizmit dhe Industrisë prodhuese
- Agjencitë e Konsulencës dhe trajnimeve
- Sektori i Organizatave Ndërkombëtare dhe NGO

PSE TË ZGJIDHNI KËTË PROGRAM?

- **PËRGATITJE PRAKTIKE PËR TREGUN E PUNËS:**

Ky program ofron një kurrikulë të thelluar dhe mundësi për praktika në projekte reale, duke zhvilluar aftësitë për të udhëhequr në industrinë e marketingut dhe komunikimit.

- **PËRDITËSIM ME TEKNOLOGJITË MË TË REJA:**

Programi përfshin praktikën dhe teknologjitë më të avancuara, si SEO, SEM, AI dhe automatizimi i marketingut, duke përgatitur studentët për një botë digjitale.

- **PËRVOJA PRAKTIKE DHE PUNË NË GRUP:**

Studentët punojnë në projekte praktike dhe bashkëpunojnë për të zhvilluar aftësitë e menaxhimit të projekteve dhe zgjidhjeve marketingu.

- **RRJETËZIM ME PROFESIONISTË:**

Mundësi për të ndërtuar lidhje me ekspertë të industrisë përmes seminareve dhe mentorimit, duke rritur mundësitë për zhvillim profesional.

- **MBËSHTETJE DHE MENTORIM:**

Profesionistë të fushës ofrojnë mbështetje dhe mentorim, duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive praktike dhe strategjike.

- **PËRGATITJE PËR KARRIERË GLOBALE:**

Programi ofron aftësitë e nevojshme për të punuar në tregje ndërkombëtare dhe për kompanitë globale.

- **DIPLOMË E KËRKUAR NË TREG:**

Ky program ofron një diplomë të çmuar që hap mundësi për punësim dhe avancim në karrierë, si dhe mundësinë për të krijuar një biznes të vetin.

- **PËRGATITJE PRAKTIKE PËR TREGUN E PUNËS:**

Ky program ofron një kurrikulë të thelluar dhe mundësi për praktika 1-mujore pranë kompanive partnere dhe agjencive të marketingut, duke zhvilluar aftësitë për të udhëhequr në industrinë e marketingut dhe komunikimit.

- **PROJEKT DIPLOMË MBI RASTE REALE:**

Studentët punojnë në grupe 2-3 studentësh në një projekt konkret me mbështetjen e kompanive/agjencive partnere dhe mentorim nga stafi akademik dhe profesionistë të industrisë. Afatet e dorëzimit dhe mbrojtjes janë të strukturuar për të siguruar përgatitje të plotë profesionale.

- **INTERNSHIP DHE MUNDËSI PUNËSIMI:**

Studentët mund të përfitojnë nga internship-et dhe punësimi potencial me partnerë shqiptarë dhe rajonalë, duke përfshirë BALFIN Group dhe kompanitë partnere, si dhe mundësi pjesëmarrjeje në konkurse, inkubatorë startup-esh.

METODA E

MËSIMDHËNIES

1

Mësim Interaktiv dhe Projekte Reale:

Diskutime, analiza rastesh dhe punë praktike që nxisin mendimin kritik dhe zbatimin e koncepteve të marketingut dhe komunikimit digjital në situata reale biznesi.

2

Challenge-Based Learning (CBL):

Studentët përballen me sfida konkrete të tregut dhe punojnë në zgjidhje inovative nën mentorimin e ekspertëve të industrisë.

3

Workshop-e dhe Seminare me Ekspertë të Industrisë:

Sesione të drejtuara nga profesionistë vendas dhe ndërkombëtarë që ndajnë praktikën më të fundit dhe teknologjitë e reja në marketingun digjital.

4

Simulime Profesionale të Fushatave Digjitale:

Përdorim i platformave dhe software-ve profesionale (p.sh. për SEO, SEM, automatizim marketingu, analiza të të dhënave) për të ndërtuar dhe menaxhuar fushata të ngjashme me ato të tregut real.

5

Guest Lecturers – Module të Veçanta:

Prezantime dhe mësimdhënie nga profesionistë të njohur të industrisë, të cilët ndajnë përvoja konkrete, praktika të suksesshme dhe njohuri të avancuara për modulet e programit.

6

Mentorim dhe Rrjetëzim Profesional:

Udhëzime të personalizuar nga mentorë të industrisë dhe mundësi për rrjetëzim me profesionistë e kompani partnere për zhvillim karriere.

7

Vizita Praktike në Kompani dhe Agjenci Partnere:

Eksperiencia “onsite” që u japin studentëve njohuri konkrete mbi funksionimin departamenteve të marketingut dhe komunikimit në kompani të ndryshme.

8

Mësim Bazuar në Projekte dhe Feedback i Vazhdueshëm:

Studentët punojnë në projekte konkrete për kompani reale, ndërsa marrin udhëzime dhe vlerësime të vazhdueshme për të përmirësuar strategjitë dhe aftësitë e tyre profesionale.

INFORMACION PRAKTIK

TË DHËNAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT



MASTER PROFESIONAL “MARKETING DIGJITAL & KOMUNIKIM” 60 ECTS

Nr.	SEMESTRI	Lënda	ECTS
-----	----------	-------	------

A – LËNDË BAZË/ 5%-10%/ 6 ECTS

1	1	Kërkim Marketing	6
---	---	------------------	---

B – LËNDË KARAKTERIZUESE TË PROGRAMIT/ 30%-40%

1	1	Marketingu i Përmbajtjes dhe Etika	5
2	1	SEO&SEM	5
3	1	Marketingu Digjital dhe Marketingu në Media Sociale	5
4	1	Menaxhimi i Markës	4
5	2	Tregtia Elektronike dhe Shitjet Digjitale	5

C – LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE 20%-30%/ 18 ECTS*

1	1	Automatizimi i Marketingut dhe Inteligjenca Artificiale	5
2	2	Planifikimi dhe Blerjet përmes Medias Digjitale	5
3	1	Komunikim Biznesi në Epokën Digjitale	5
4	2	Analizë Biznesi	4
5	2	Komunikimi i Korporatave dhe ‘StoryTelling’	5
6	2	Strategji Marketing	5

*Studentët do zgjedhin 3 nga 6 lëndë të ofruara.

D- LËNDË PLOTËSUESE/ 10%/ 6 ECTS

1	2	Praktikë Profesionale	6
---	---	-----------------------	---

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 10%-20%/ 6 ECTS

1	2	Diplomë/Provim i Përgjithshëm	9
---	---	-------------------------------	---

TOTAL			60
-------	--	--	----

KËRKESAT E PRANIMIT:

- Diplomë Bachelor
- CV
- Dokument identifikimi

KONTAKTET:

☎ +355 69 70 66 966

🌐 www.tbu.edu.al

✉ info@tbu.edu.al

✉ admissions@tbu.edu.al

📍 Rr. “Rezervat e Shtetit”, Lundër, Tiranë, Shqipëri

📧 tbu.edu.al

📘 Tirana Business University College

🌐 Tirana Business University College